



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Kuvendi 2020-2024: Kush i përfaqëson qytetarët?


Autore: Vlora Reçica

Mbledhësit e të dhënave: Zdravko Stavrov, Pero Jovanovski, Iva Naskova

dhjetor 2021

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) ka 120 deputetë me profile dhe biografi të ndryshme. Sipas Kushtetutës, deputetët përfaqësojnë qytetarët në organin më të lartë legjislativ, por analiza e opinionit publik të Institutit për Demokraci në vitin 2021 tregon se për gati një të tretën (29%) e të anketuarve emrat e deputetëve nga njësia e tyre zgjedhore janë të panjohura, ndërsa në vitin 2020, për madje 48% të të anketuarve deputetët e tyre ishin të panjohur.

Sipas informacioneve në dispozicion në bazën globale të të dhënave të Unionit Ndërparlamentar (UNP), nga 120 deputetë në Kuvendin maqedonas, 70 janë burra, ndërsa 50 janë gra, përkatësisht 42% e numrit të përgjithshëm të deputetëve në Kuvend.¹




¹ Baza globale e të dhënave të parlamenteve kombëtare.
Qasur më: https://data.ipu.org/node/171/basic-information?chamber_id=13391 (Vizita e fundit: 16.12.2021)


Sipas kësaj baze të të dhënave, deputeti më i vjetër është 72 vjeç, ndërsa përfaqësuesi më i ri është 24 vjeç. Moshja mesatare e deputetëve në mandatin 2020-2024 është 49.7 vjeç. Shumica e deputetëve sipas kësaj baze janë nga 31 deri në 40 vjeç, dhe atë 34 deputetë, prej të cilëve 20 janë burra dhe 14 gra. Nga ana tjetër, numri më i vogël i deputetëve janë të moshës 71 deri në 80 vjeç, përkatësisht 3 deputetë, prej të cilëve 2 burra dhe 1 grua.



Në Kuvend aktualisht janë të përfaqësuar 20 parti politike dhe dy deputetë të pavarur, të organizuar në dy koalicione të mëdha të Bashkimit Socialdemokrat i Maqedonisë (LSDM) dhe VMRO-DPMNE-së, si dhe katër parti të pavarura, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Aleancës për Shqiptarët, të Majtës dhe Partisë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH). Pesë prej tyre janë deklaruar si parti etnike shqiptare, dy si parti etnike turke, dy si parti etnike serbe, ndërsa 11 janë parti etnike maqedonase. Kjo përbërje e Kuvendit ka një deputete të etnisë rome, 33 shqiptarë etnik, dy turq etnik, tre serbë etnik, një boshnjak dhe 80 deputetë maqedonas.



Nga fillimi i këtij mandati në gusht të vitit 2020, 22 deputetëve u përfundoi mandati para kohe, nga të cilët 4 gra dhe 18 burra ose gjithsej 18% e përbërjes fillestare të Kuvendit është ndryshuar. Shumica e ndryshimeve ndodhin për shkak se deputetët e larguar nga legjislativi janë zgjedhur ose emëruar në poste të zgjedhura ekzekutive, të cilat janë të papajtueshme me mandatin parlamentar. Ndryshimet e shpeshta në përbërjen e parlamentit krijojnë pasiguri te qytetarët se kush i përfaqëson dhe rezultojnë në mosnjohje të qytetarëve me përfaqësuesit e tyre.



PROFILET E DEPUTETËVE SIPAS NIVELIT ARSIMOR

Gjysma e deputetëve të Kuvendit aktual (50%) kanë përfunduar arsimin e lartë - 38 prej tyre janë burra dhe 22 janë gra. Më shumë se një e katërta (27%) e deputetëve në Kuvendin aktual kanë përfunduar studimet master, prej të cilëve 19 janë burra, ndërsa 13 janë gra. Pothuajse një e katërta (22%) e deputetëve kanë përfunduar studimet doktoraturë, prej të cilëve 12 janë burra dhe 15 gra. Vetëm një deputet në Kuvendin aktual ka përfunduar vetëm arsimin e mesëm.

Tabela 1. Shkalla e arsimit të deputetëve nga mandati 2020-2024

Shkalla e arsimit	Burra		Gra		Totali	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Arsim i mesëm	1	1%	0	0%	1	1%
Arsim i lartë	38	63%	22	37%	60	50%
Studime të magjistraturës	19	59%	13	41%	32	27%
Studime të doktoratës	12	44%	15	56%	27	22%

Shumica e deputetëve me arsim të lartë kanë diplomuar juridikun - 6 prej tyre janë burra dhe 6 gra. Të ndjekur nga deputetët me diplomë në ekonomi, nga të cilët të 7 janë burra. Pasohen nga deputetë me diplomë në pedagogji dhe deputetë të diplomuar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore. Konkretisht, në Fakultetin Pedagogjik kanë diplomuar 2 burra dhe 3 gra, ndërsa në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore 2 burra dhe 3 gra. Fakultetin e Mjekësisë kanë mbaruar katër deputetë - 3 burra dhe 1 femër. Ndërsa gjithsej 9 deputetë kanë diplomuar në Fakultetin Stomatologjik, Filozofik, dhe atë të Bujqësisë. Prej tyre, 2 burra dhe 1 femër kanë mbaruar Fakultetin e Stomatologjisë, njësoj si në Fakultetin e Bujqësisë. Në Fakultetin Filozofik raporti i deputetëve të diplomuar është i kundërt - 1 burrë dhe 2 gra. Vetëm 2 deputetë janë diplomuar në Fakultetin e Edukimit Fizik, Sportit dhe Shëndetit (PESH), 2 në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe 2 deputetë janë me diplomë deridiplomike në Turizëm, Menaxhim dhe Hoteleri. Prej tyre, 1 burrë dhe 1 grua kanë diplomuar në EFSSH, duke përfshirë deputeten e parë rome në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa 2 burra kanë diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike. Deputetët kanë diplomë edhe në turizëm, menaxhim dhe hoteleri, siç është rasti me 1 burrë dhe 1 grua. Dy prej deputetëve kanë më shumë se një diplomë deridiplomike. Deputeti Panço Minov ka diplomë në drejtësi dhe shkencë politike, ndërsa deputetja Dragica Gjavočanova ka diplomë në shkencat matematiko-natyrore dhe në inxhinieri kompjuterike.

Tabela 2. Arsimit i lartë

I/e diplomuar në:	Burra	Gra	Totali
Juridik	6	6	12
Ekonomi	7	0	7
Pedagogji	2	3	5
Shkenca Matematiko-Natyrore	2	3	5
Mjeksi	3	1	4
Stomatologji	2	1	3
Bujqësi	2	1	3
Filozofi	1	2	3
Edukim fizik, sport dhe shëndet (EFSSH)	1	1	2
Inxhinieri Mekanike	2	0	2
Turizëm, Menaxhim dhe Hoteleri	1	1	2
Gjuhë maqedonase	0	1	1
Menaxher në sigurime	1	0	1
Akademi Ushtarake	1	0	1
Arkitekturë	1	0	1
Inxhinieri Elektrike	1	0	1
Teknologji dhe Metalurgji	0	1	1
Histori	1	0	1
Psikologji	0	1	1
Dizajn dhe teknologji të mobiljeve dhe dizajnit të brendshëm	1	0	1
Arte të bukura	1	0	1
Mbrojtje	1	0	1
Paspecifikuar	1	0	1

Deputetët me diplomë master kanë diplomuar kryesisht në drejtësi dhe ekonomi, megjithatë, 6 deputetë që kanë deklaruar se kanë mbaruar studimet master nuk kanë specifikuar fushën e studimeve. Katër deputetë burra kanë magjistruar në shkencat juridike, ndërsa të njëjtën kanë deklaruar 2 deputete gra. Nga ana tjetër, 3 gra dhe 3 burra kanë magjistruar në shkencat ekonomike. Gjithashtu, 3 deputete kanë përfunduar studimet për menaxhim të burimeve njerëzore, të gjitha deputete gra. Dy deputetë kanë master në shkencat politike, ndërsa deputetët gjithashtu kanë master në media dhe komunikim, arsim dhe menaxhim arsimor, marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci, studime të sigurisë, akademi ushtarake, inxhinieri civile – gjeodezi, informatikë dhe shkencat sociale.

Tabela 3. Studime të magjistraturës

Studime të magjistraturës në:	Burra	Gra	Totali
Shkencat juridike	4	2	6
Shkenca Ekonomike	3	3	6
Paspecifikuar	4	2	6
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	0	3	3
Shkenca Politike	2	0	2
Menaxhment	1	0	1
Media dhe Komunikim	1	0	1
Arsimi dhe Menaxhimi Arsimor	0	1	1
Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	0	1	1
Studimet e Sigurisë	1	0	1
Akademia Ushtarake	1	0	1
Informatikë	0	1	1
Inxhinieri Ndërtimi – Gjeodezi	1	0	1
Shkencat shoqërore	1	0	1

Nga deputetët që kanë doktoraturë, shumica kanë përfunduar studimet e doktoraturës në fushën e shkencave juridike (7 deputetë), ndërsa 11 deputetë kanë specializuar në mjekësi. Fushat tjera në të cilat deputetët kanë përfunduar studimet e doktoraturës përfshijnë studimet folklorike, shkencat ekonomike, biokimi, histori, shkencat pyjore, shkencat teknike, gjuhësia dhe shkencat kompjuterike.

Tabela 4. Studime të doktoratës

Studime të doktoratës në:	Burra	Gra	Totali
Mjekësi	4	7	11
Juridik	3	4	7
Histori	2	0	2
Studime folklorike	0	1	1
Ekonomik	1	0	1
Shkencat e Biokimisë	0	1	1
Shkenca Pyjore	1	0	1
Shkenca Teknike	0	1	1
Gjuhësi - anglisht	0	1	1
Shkenca Kompjuterike	1	0	1

Profillet e varfra të deputetëve të publikuara në ueb-faqen e Kuvendit e vështirësojnë qasjen në informacione që janë vendimtare për njohjen e qytetarëve me përfaqësuesit e tyre. Po ashtu, ka ndikim edhe publikimi jo në kohë i biografive të deputetëve, pasi disa deputetë gjatë kohës nuk kanë profilin e tyre zyrtar në faqen e Kuvendit. Në raste të tilla, qytetarët duhet të kërkojnë të dhënat për deputetët e tyre nga burime alternative në internet, ku të dhënat nuk janë gjithmonë të plota. Në përgjithësi biografite të deputetëve, siç është paraqitur për publikun në ueb-faqen e Kuvendit, nuk përmbajnë informacione të mjaftueshme që qytetarët të njihen në mënyrë thelbësore me përfaqësuesit e tyre. Për të hyrë në biografite të qasshme të përfaqësuesve të zgjedhur, klikoni në lidhjen e mëposhtme - <https://www.sobranie.mk/segashen-sostav-2020-2024.nspx>.



Ky Publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PMP), e mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PMP, zbatohet nga Instituti Nacional Demokratik (IND), Institutit për Demokraci „Societas Civilis“ – Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Kriza (QMK). Përmbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet e SDC.